



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25 dhe Nenin 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 7, Nenit 18 paragrafi 3, Nenit 24 dhe Nenit 32 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, (Ligji Nr. 03/L-043),
- Aplikacionin për vazhdim të licencës për prodhim të energjisë elektrike të bërë në ZRRE me datë 18.03.2015 nga ndërmarrja Korporata Energjetike e Kosovës –Divizioni i Gjenerimit “KEK SH.A.”-TC Kosova “A”, adresa: rruga “Nënë Tereza nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
- Kërkesën për shtyrje afati të licencës për prodhim të energjisë elektrike për TC Kosova A, e datës 18.03.2015; dhe
- Njoftimin për aplikacionin për marrjen e Lejes Mjedisore të Integruar, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me Nr. Prot:737-2/15, të datës 12.03.2015;

në seancën e mbajtur me datë 16 korrik 2015, nxori këtë:

VENDIM

- I. I VAZHDOHET** licenca për prodhim të energjisë elektrike Korporatës Energjetike të Kosovës – Divizioni i Gjenerimit (KEK SH.A.)-TC Kosova A, me numër licence ZRRE/Li_05/13_A, për periudhën nga **04 tetor 2015** deri **04 tetor 2016**.
- II. Obligohet** KEK SH.A. që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të këtij vendimi të sigurojë Lejen Mjedisore të Integruar nga MMPH, dhe kopjen e së njëjtës ta dërgojë në ZRRE.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 18.03.2015 ka pranuar nga KEK SH.A Kërkesën për Vazhdim Licence për prodhim të energjisë elektrike të KEK Sh.a. – Divizioni i Gjenerimit”-TC Kosova “A” për periudhën nga 04.10.2015 deri me 04.10.2020.
- Bordi i ZRRE-së që nga viti 2011 i ka vazhduar licencën për prodhim të energjisë elektrike ndërmarrje KEK SH.A-TC Kosova A çdo vit (vendimet: V_380_2011 i datës 30 shtator 2011, V_437_2012 i datës 01 tetor 2012, V_556_2013 i datës 06 shtator 2013 dhe V_652_2014 i datës 03 tetor 2014), duke obliguar të licencuarin që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të këtyre Vendimeve, ta sigurojë nga MMPH Lejen Mjedisore të Integruar, dhe një kopje ta dërgojë në ZRRE.



- Sipas Njoftimit të MMPH-së të datës 12.03.2015, KEK Sh.A ka bërë kërkesë me datë 18.02.2015 me nr. protokoli 737/15 në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për marrje të Lejes Mjedisore të Integruar. KEK SH.A e ka bërë kërkesën në MMPH me qëllim të përmbushjes së dispozitave të licencës dhe po ashtu edhe obligimit të përcaktuar në vendimin V_652_2014, me datë 18.02.2015.
- Në Njoftimit e MMPH-së të datës 12.03.2015 thuhet se: *MMPH ka pranuar aplikacionin për Leje Mjedisore të Integruar dhe është duke e shqyrtuar lëndën në bazë të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, (Ligji Nr. 03/L-043), ku Neni 11 i këtij ligji parasheh që të gjitha impiantet ekzistuese, në këtë rast KEK-u, duhet të harmonizohen me kërkesat që përcaktohen me dispozitat e këtij ligji jo më larg se 31 dhjetor 2017, duke marrë parasysh Planin e propozuar të Orarit të Përputhshmërisë për atë impiant. Duke u nisur nga fakti që zbatimi i dispozitave që dalin nga ligji i lartpërmendur kërkojnë një analizë të thellë të gjendjes teknike të instalimeve të KEK-ut, që paraqesin një kompleks të madh industrial por edhe me një vjetërsi të konsiderueshme, do të kërkojë një bashkëpunim i ngushtë me KEK-un për të planifikuar mirë kohën e plotësimit të kushteve për përmbushjen e standardeve të përcaktuara me legjislacionin për mjedis. Sipas Vendimit të Kryeministrit Nr.04/156 të datës 13.11.2013 mbyllja e njehsive aktive të TC Kosova A do të bëhet në përputhje me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës. Në këtë rast plani i propozuar i Orarit të Përputhshmërisë për impiantet e KEK-ut do të bazohet në dokumentin e lartpërmendur. Pas shqyrtimit të raportit dhe plotësimit të kushteve të parapara në nenin 9 të ligjit të lartpërmendur MMPH do të lëshojë Vendimin për Leje Mjedisore të Integruar.*
- ZRRE duke marrë parasysh këtë që u tha më lartë, dëshmitë e bashkëngjitura aplikacionit për vazhdim licence dhe sipas dispozitave ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.




Vendimi i dërgohet:

- Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A) TC Kosova A
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i ZRRE-së



Enver Halimi, kryesues



Merita Kostari, anëtare



Krenar Bujupi, anëtar